



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË VLORË

V E N D I M

Nr. 66, datë 20.12.2012

**“MBI STRUKTURËN ORGANIZATIVE TË BASHKISË DHE INSTITUCIONEVE
VARTËSE – VITI 2013”**

Këshilli i Bashkisë Vlorë, në mbledhjen e datës 20.12.2012, në mbështetje të:

- Ligjit Nr.8652, datë 31.07.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 32, gërma ç, neni 2, pika 2, 3, neni 44, gërma e, ë, f,
- VKM Nr.518, datë 16.8.2012 “Për disa ndryshime në Vendimin Nr.1619, datë 2.07.2008, të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page e për caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”.
- VKM Nr.513, datë 01.07.2002 “Për caktimin e strukturës, numrit të punonjësve dhe shpenzimeve buxhetore të policisë së bashkisë dhe të komunës”
- Ligji Nr. 9780, date 16.07.2007, “ Për inspektoriatin e ndërtimit”, Neni 18:

dhe në referencë të VKM Nr.474, datë 16.6.2011 “Për përcaktimin e standardeve e të procedurës që duhet të ndiqet gjatë hartimit dhe miratimit të strukturave organizative të institucioneve të administratës publike”


V E N D O S I

- I. Të miratojë strukturën, nivelin e pagave dhe numrin e punonjësve të administratës së Bashkisë Vlorë për vitin 2013 deri në miratimin e strukturës të vitit pasardhës, me numër të përgjithshëm **206 (+13)**, me përbërje si më poshtë (tabela bashkengjitur)

1. Drejtues	1 person
2. Kabineti i Kryetarit	4 persona
3. Këshilli i Bashkise	2
4. Administratori i qytetit	11
5. Drejtoria Juridike	6
6. Njësia e Auditimit të Brendshëm	3
7. Drejtoria e Burimeve Njerëzore	6
8. Drejtoria e Informacionit dhe Marrëdhënieve me Publikun	6
9. Drejtoria e Financë – Buxhetit dhe Kontabilitetit	32
10. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore	31
11. Drejtoria e Planifikimit të Territorit	14
12. Drejtoria e Projektimit dhe Urbanizimit	5
13. Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve	16
14. Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Shëndetit Publik	26
15. Drejtoria e Ndihmës dhe Shërbimit Social	10
16. Njësia e Programim – Zhvillimit	2

17. Inspektoriati Ndërtimor Urbanistik	9
18. Policia Bashkiake	20
19. Zyra e Gjendjes Civile	(+10)
20. Qendra e Regjistrimit të Biznesit	(+3)

- II. Të miratojë 2 (dy) punonjës – specialistë të nivelit të lartë, me kohë të pjeshme (3 orë/ditë), për të gjitha ditët e punës në javë.
- III. Të miratojë strukturën, nivelin e pagave dhe numrin e punonjësve të institucioneve dhe njësive vartëse si më poshtë (tabela bashkëngjitur – gjithsej **214**):
- | | |
|---|-----|
| 1. Ndërmarrja e Shërbimeve Publike | 133 |
| 2. Teatri “Petro Marko” | 30 |
| 3. Qendra e Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve | 25 |
| 4. Klubi Shumësportesh “Flamurtari” | 14 |
| 5. Qendra e Zhvillimit të PAK | 5 |
| 6. Shtëpia e Fëmijës | 7 |
- III. Të miratojë për 3 (tre) aktorë të estradës me arsim të mesëm (Qytetarë Nderi) kategorinë III-B me pagën mujore 33.000 lekë.
- IV. Të miratojë shpërblimin mujor të Këshilltarëve të Këshillit të Bashkisë në masën 10% të pagës së Kryetarit të Bashkisë.
- V. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit 8652, datë 31.07.2000, neni 33, pika 6.


Etjona HOXHA
KRYETARE

